



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1679 prot.

Elbasan, me 09.07.2021

VENDIM

Nr 28 datë 09.07.2021

"PËR

**KRIJIMIN E SHOQATËS SPORTIVE STUDENTORE TË UNIVERSITETIT TË ELBASANIT
'ALEKSANDËR XHUVANI'"**

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, Statutit të UE-së, si dhe bazuar në rekomandimin e Kryeministrit dhe Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, me qëllim aderimin në Federatën Shqiptare të Sportit Universitar, Vendimit të Senatit Akademik Nr. 15, datë 02.07.2021 "Për shprehjen e dakordësisë për krijimin e shoqatës sportive studentore të Universitetit të Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani'", VBA nr. 8, datë 06.03.2021" Për miratimin e plan buxhetit të vitit 2021", Bordi i Administrimit ,

VENDOSI:

1. Krijimin e Shoqatës Sportive Studentore të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani".
2. Shpenzimet e procesit të krijimit të shoqatës sportive studentore të përballohen nga fondet në dispozicion në zërin "Shpenzime për të tjera materiale dhe shërbime operative"
3. Ngarkohet Administratori i Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



**KRYETARI I BORDIT
ARDIAN DURMISHI**